



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA STUDIMI NË BRUNEI DARUSSALAM
VITI AKADEMIK 2021-2022**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme shpall thirrjen për bursa nga Brunei Darussalam për vitin akademik 2021-2022.

Aplikantët për bursë duhet t'i përkasin grupmoshës 18-25 vjeç për programet universitare Bachelor dhe nuk duhet të jenë mbi 35 vjeç për programet pasuniversitare Master

Afati i aplikimit për bursë është jo më vonë se **15 shkurt 2021**.

Këto bursa përfshijnë në programin e tyre, studime universitare Bachelor dhe pasuniversitare Master, në secilin nga institucionet e mëposhtëm:

- Universiteti Brunei Darussalam (UBD);
- Universiteti Islam Sultan Sharif Ali (UNISSA);
- Universiteti Teknologji Brunei (UTB);
- Politeknik Brunei (PB).

Në bursat e ofruara nga Brunei Darussalam përfshihet:

- përjashtim nga pagesa e tarifave të shkollimit duke përfshirë tarifat e pranimit, provimit, regjistrimit dhe orientimit për kohëzgjatjen e programit;
- një biletë avioni e klasit ekonomik për në Brunei Darussalam nga vendi i nisjes/vendbanimi i bursistit para fillimit të kursit dhe një biletë avioni e klasit ekonomik nga Brunei Darussalam në vendin prej nga është nisur/vendbanimit të bursistit pas përfundimit të kursit;
- pagë mujore për shpenzime personale prej afro 312 EUR;
- pagë mujore për vaktet prej afro 93 EUR;
- kompesim vjetor për librat shkollorë prej afro 374 EUR;
- akomodimi në kolegjin rezidencial të Universitetit/Politeknikut;
- pas përfundimit të programit, bursistit i lejohet dërgimi i bagazheve të tij, drejt vendbanimit për një tarifë prej:
 - i. 156 EUR drejt një vendi brenda rajonit të ASEAN;

- ii. 312 EUR drejt një vendi jashtë rajonit të ASEAN.
- siguracion mjekësor i plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së bursës.

Aplikimet për bursë bëhen drejtpërdrejtë në faqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Brunei Darussalam, aplikuesit shkarkojnë një format të gatshëm aplikimi (bashkëlidhur kësaj shpalljeje), ky aplikim duhet të miratohet nga Ministria e Punëve të Jashtme ose pika e kontaktit të vendit të aplikuesit, pas miratimit këto aplikime dërgohen me postë elektronike drejt linkut të paraqitur në faqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Brunei Darussalam.

I gjithë informacioni mund të gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme Brunei Darussalam, në links e mëposhtëm:

<http://www.mfa.gov.bn/Pages/bdgs2021.aspx>

<https://apply.ubd.edu.bn/orbeon/uis-welcome/>

<http://www.mfa.gov.bn/PublishingImages/bdgs2021/BDGS%20APPLICATION%20FORM%202020-2021.doc>

Si dhe për informacion më të detajuar Ministria e Punëve të Jashtme të Brunei Darussalam ka vënë në dispozicion këtë adresë email-i: scholarship@mfa.gov.bn

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS